



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 18 Datë 21 janar 2019

Për plotësimin e pozicioneve të këshilltarëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë përmes procedurës së komandimit të prokurorëve

Në përputhje me nenin 53/2 Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 176/3 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

Neni 1

Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 6 (gjashtë) pozicioneve të këshilltarëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë përmes procedurës së komandimit të prokurorëve.

Neni 2

Prokurorët e komanduar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë do të ndihmojnë Komisionin e Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në procesin e vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve në kuadrin e Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Afati i Komandimit do të jetë 1 (një) vit me mundësinë e përtëritjes në varësi të nevojave të punës së Këshillit dhe performancës së prokurorit gjatë periudhës së komandimit.

Neni 4

Ftohen të gjithë prokurorët e shkallës së parë dhe të dytë që nuk shërbejnë në një pozicion me mandat të kufizuar¹ dhe që nuk janë të komanduar në ndonjë pozicion tjetër që të shprehin interesin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

¹ Në KLP ose SPAK

Neni 5

Shprehja e interesit duhet të bëhet jo më vonë se 2 (dy) javë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe të dorëzohet në adresën:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Qemal Stafa" Nr. 1 Tiranë

Mbi zarf duhet të shënohet: "Shprehje Interesi për Komandim"

Shprehja e Interesit duhet të përmbajë shpjegimet e kandidatit për arsyet e kandidimit (*jo më shumë se 2 faqe A4*).

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

